Projekti “Certifikoni italishten tuaj. Gjuha për t’u përfshirë në shoqëri, për punën dhe nënshtetësinë”

Viti mësimor 2011/12

Evropa - Italia

Tekste prezantimi në ppt

Slide 1

TË JETOSH KËTU … NË EVROPË

Slide 2

… NË ITALI

…. NË LOMBARDI

Slide 3

TË NJOHËSH ITALINË

Në Itali, pushtetet publike janë katër:

- Bashkimi Evropian
- Shteti italian
- Rajonet
- Komunat

Këto pushtete rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e personave

Slide 4

BASHKIMI EVROPIAN (BE)

Përbëhet nga 27 vende (vende anëtare)

- Vendet anëtare duhet të ndjekin direktivat e BE-së: për shembull direktivën për persona me leje qëndrimi afatgjatë në KE

- Vendet anëtare i hartojnë ligjet kombëtare në bazë të direktivave të BE-së

Slide 5

SHTETI ITALIAN

Siguron financimet për shërbimet publike kryesore:
- sigurinë publike
- transportet
- shëndetësinë

- arsimimin
- drejtësinë
- ...

Kuestura dhe Prefektura janë zyra shtetërore

Slide 6

SIGURIA PUBLIKE

- Policia dhe karabinierët
  * kontrollojnë lejet e qëndrimit
  * marrin denoncimet
  * arrestojnë personat për krime të rënda
  * vënë gjoba

- Policia financiare kontrollon pagesën e taksave
- Inspektorati i punës kontrollon respektimin e ligjit në vendin e punës
- Policia lokale (policia rrugore)
  * kontrollon trafikun, aktivitetet tregtare (dyqanet, tregjet ..), vendbanimet dhe të dhënat personale
  * ruan mjedisin dhe higjienën publike
  * vë gjoba

Slide 7

RAJONET ITALIANE

Janë 20 rajone dhe ato administrojnë shumë shërbime:
- shëndetësinë dhe shërbimet për shëndetin e shtetasve
- formimin profesional
- transportet lokale
- ...

Slide 8

KOMUNAT ITALIANE

Janë 8101 në gjithë Italinë
Në Lombardi janë 1544

Të gjitha administrojnë shërbime shumë të rëndësishme për shtetasit

* shërbimet personale (karta e identitetit, certifikata e banimit, gjendja civile ...)
* shërbimet e asistencës sociale për familjet, të miturit (fëmijët dhe të rinjtë nën 18 vjeç), të moshuarit
* shërbimet për shkollën (mensa, transportet shkollore …)

Slide 9

PARIMI I BARAZISË

Ligji më i rëndësishëm i Italisë është "Kushtetuta".

Kushtetuta thotë se:
- të gjithë shtetasit janë të barabartë pa dallim gjinie, feje, gjuhe apo kombësie
- për shembull, burri dhe gruaja kanë të njëjtat detyra dhe detyrime
- të gjithë janë të barabartë përpara ligjit

Në rast diskriminimi
- çdo shtetas ka të drejtë të shkojë përpara një gjykatësi për të kërkuar të drejtën e tij

Kujdes

Emigrantët që nuk janë me dokumente të rregullta kanë vetëm të drejtat themelore, për shembull të marrin mjekim urgjent pranë urgjencës

Slide 10

TË GJITHË SHTETASIT JANË TË BARABARTË

Nëse një shtetas i huaj jeton në Itali me **dokumente të rregullta**, ka të njëjtat të drejta dhe detyrime me shtetasit italianë

Të drejtat, *për shembull:*
* e drejta për shërbime shëndetësore dhe mjekim në rast sëmundjeje
* e drejta e shkollimit për fëmijët dhe të rinjtë nën 18 vjeç
* e drejta për punë
* ...

Detyrimet, *për shembull:*
* respektimi i ligjit
* pagesa e taksave
* ...

Slide 11

POR VETËM SHTETASIT ITALIANË ...

kanë të drejta politike:
- për të votuar dhe zgjedhur përfaqësuesit e tyre
- për t'u zgjedhur në poste publike
- për të punuar në administratën publike

Kujdes

Shtetasit e vendeve që bëjnë pjesë në Bashkimin Evropian mund të marrin pjesë në zgjedhjet lokale dhe të punësohen në sektorin publik

Slide 12

LIGJET MBI EMIGRACIONIN

Çdo vend i Bashkimit Evropian ka ligjet e veta të emigracionit.
Në Itali ka rregulla për shtetasit e BE-së dhe rregulla të tjera për shtetasit jashtë BE-së, për shembull:

- shtetasi i BE-së duhet të regjistrohet në zyrat e regjistrimit
- shtetasi jashtë BE-së duhet të ketë leje qëndrimi dhe mund të hyjë me disa kushte

ndërsa

ata që kërkojnë azil për motive politike ose humanitare kanë të drejtën e strehimit dhe mbrojtjes ndërkombëtare pa dallim. Në këtë rast Italia ndjek ligjet evropiane